

STATUTI

I SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “TIRANA BUSINESS UNIVERSITY”

SHLUP TBU

Tiranë, 8 Nëntor 2014

Miratuar me vendim të Bordit Drejtues të TBU

Presidenti Artan Hoxha

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Ky Statut mbështetet në legjislacionin për arsimin e lartë dhe në çdo ligj tjetër që përcakton rregulla për aktivitetet që kryhen nga shkolla e lartë Tirana Business University (TBU) si dhe në legjislacion tregëtar mbi të cilin vepron TBU Sh.p.k.

Neni 2

Statusi dhe selia

Statusi juridik tregëtar i TBU sh.p.k. është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L01801024T. TBU sh.p.k., si shoqëri tregëtare, administrohet sipas legjislacionit tregëtar në fuqi, statutit të shoqërisë dhe akteve të tjera rregullatore dhe individuale të autoriteteve tregëtare të shoqërisë.

Statusi akademik i TBU është Shkollë e Lartë e tipit Universitet. TBU si shkollë e lartë administrohet sipas legjislacionit të arsimit të lartë, statutit të shkollës së lartë TBU, rreglores së përgjithshme, rregulloreve të programeve, akteve të tjera rregullatore dhe individuale të autoriteteve akademike.

Selia e TBU është në adresën : Rruga e Kavajës, 1023, Tiranë, Shqipëri.

Në këtë statut, kur flitet për shoqërinë dhe aspektet tregëtare do të përdoret termi TBU Sh.p.k. ose "shoqëria" dhe sa herë flitet për shkollën e lartë do të përdoret termi TBU ose "shkollë".

Neni 3

Harmonizimi i statusit tregëtar me atë akademik

Statusi tregëtar dhe statusi akademik janë të dallueshëm, në pavarësi relative dhe në harmoni mes tyre, në përputhje me parimet dhe rregullat e legjislacionit në fuqi, ato të përcaktuara në statutin e shoqërisë dhe ato të përcaktuara në këtë statut të shkollës.

Personeli mësimor - shkencor i "TBU" gëzon liri të plotë akademike në procesin mësimor dhe në kërkimin shkencor. Personeli mësimor ushtron, përmes strukturave akademike të parashikuara në këtë statut, kompetenca vendimmarrëse të gjera dhe të plota lidhur me të gjitha aspektet akademike të veprimtarisë së TBU duke mirëkuptuar dhe respektuar njëkohësisht të drejtat e shoqërisë dhe të ortakëve të saj.

Ortakët e shoqërisë ushtrojnë të gjitha të drejtat që burojnë nga legjislacioni tregëtar, pa ndërhyrë në kompetencat e strukturave akademike, duke mbështetur, mirëkuptuar dhe respektuar të drejtat e strukturave akademike, personelit mësimor dhe studentëve të TBU.

Neni 4

Paprekshmëria e Mjedisve të Universitetit

Të gjitha mjediset e "TBU" gëzojnë paprekshmëri të plotë në kuptimin e legjislacionit për arsimin e lartë.

KREU II

STRUKTURA, MISIONI, OBJEKTIVAT DHE AUTORITETET DREJTUESE

Neni 5

Struktura Organizative

Struktura organizative e "TBU" përbëhet nga njësitë kryesore, që janë:

- Fakulteti i Administrimit të Biznesit
- Fakulteti i të Drejtës së Biznesit.

Në strukturën organizative të secilit fakultet përfshihen edhe njësitë bazë që janë:

- Departamenti i lëndëve të përgjithshme;
- Departamenti i lëndëve profesionale;
- Qendra për Kërkime e Studime (respektivisht Ekonomike dhe ajo Juridike).

Në strukturën organizative të TBU përfshihen njësitë ndihmëse si: laborator i informatikës, biblioteka, si dhe njësitë përkatëse administrative si: sekretaria mësimore, zyra e çështjeve studentore, zyra e marketingut, etj.

Neni 6

Misioni dhe Objektivat e TBU

Misioni i TBU-së është:

"Të jetë Universiteti lider në Shqipëri që harmonizon formimin teorik me aftësimin praktik të studentëve në nivel bachelor dhe master me përparësi në fushat e administrimit të biznesit, të së drejtës së biznesit, administrimit publik, duke u mbështetur në programe bashkëkohore studimi, zhvillimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore, si edhe në praktikimin intensiv të dijeve të marra nga studentët në bizneset private, institucioneve publike dhe organizatave jo-fitimprurëse, shqiptare dhe të huaja".

Misioni do të përmbushet nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të mëposhtme:

1. Ofrimi i programeve bashkëkohore të studimit të nivelit bachelor dhe master në fushat e veprimtarisë së vet akademike me fokus shkencat e administrimit të sipërmarrjeve dhe institucioneve publike si dhe ato të së drejtës tregëtare, administrative, civile.
2. Bazimi tek një personel akademik që kombinon individualisht dhe kolektivisht kompetencën teorike me eksperiencën e përditshme praktike, i aftë dhe i përkushtuar për t'i transmetuar ato tek studentët përgjatë mesimit në auditor, praktikave mësimore, drejtimit të individualizuar, këshillimit, temave të diplomave, kërkimit shkencor, ofrimit të shërbimeve për sipërmarrjet dhe institucionet, botimeve etj;
3. Ofrimi i programeve të ndryshme afatshkurtra dhe afatmesme të trajnimit dhe kualifikimit, me specifika të veçanta në disiplina të ndryshme brenda fokusit të vet kryesor;
4. Ndërtimi i marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit me kompanitë dhe organizatat përfaqësuese të biznesit, si edhe me institucionet publike dhe OJF shqiptare dhe të huaja, për realizimin e praktikave profesionale të studentëve; angazhimin e studentëve në operacionet e punës dhe ato drejtuese; punësimin e studentëve që gjatë shkollimit; kryerjen e projekteve të ndryshme të kërkimit dhe zhvillimit; ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga shkolla për sipërmarrjen dhe institucionet ku përfshihen studentët dhe pedagogët; shkollimin dhe/ose trainimit e stafeve të sipërmarrjeve, institucioneve dhe organizatave të tjera; angazhimin e personelit drejtues e me eksperiencë të këtyre organizatave në aktivitete mësimdhënëse dhe kërkimore të TBU.

5. Ndërtimi i marrdhënieve bashkëpunuese me universitete dhe institucione të tjera mësimore, kërkimore dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit, për organizimin e programeve të përbashkëta të studimeve, ndërmarrjen e projekteve të kërkim zhvillimit, organizimin e forumeve, konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe publike në të mirë të komunitetit dhe shoqërisë.

Neni 7

Autoritetet Drejtuese

Autoritetet drejtuese të TBU për çështjet tregëtare të shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, Administratori si dhe të tjera të përcaktuara në statutin e shoqërisë.

Autoritete drejtuese për çështjet akademike janë: Senati Akademik, Rektori, Dekanët, Departementet dhe Qëndrat Kërkimore, Drejtuesit e Departementeve dhe të Qëndrave, Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe çdo strukturë tjetër që ngrihet për qëllime të caktuara akademike.

Bordi Drejtues është një autoritet me natyrë të dyfishtë, në të cilin shtrohen për diskutim, konsultohen dhe harmonizohen çështjet akademike të shkollës me ato tregëtare të shoqërisë.

Qeveria studentore është autoritet i krijuar ekskluzivisht nga studentët, pa qëllime dhe aktivitete politik.

Neni 8

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është autoriteti më i lartë vendimmarrës dhe drejtues i shoqërisë për çështjet tregëtare dhe si dhe për disa nga çështjet akademike apo aspekte të tyre, për aq sa këto lidhen dhe influencojnë çështjet tregëtare të shoqërisë. Ajo mbledhet dhe funksionon sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe statutin e TBU sh.p.k.

Neni 9

Administratori

Administratori emërohet nga Asambleja e Ortakëve, ushtron kompetenca dhe vepron në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe aktet në zbatim të tij si dhe me statutin e shoqërisë. Administratori bashkëpunon me diplommat e studimeve.

Neni 10

Bordi Drejtues

Bordi Drejtues është autoritet me natyrë të dyfishtë, në të cilin shtrohen për diskutim, konsultohen dhe harmonizohen çështjet akademike me ato tregëtare.

Bordi Drejtues miraton çështjet financiare që nuk janë kompetencë ekskluzive e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve apo e Administratorit të Shoqërisë si dhe projektet e akteve që paraprakisht miratohen nga Senati Akademik.

Bordi Drejtues përbëhet nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 75% të kuotave të shoqërisë, Administratori Shoqërisë si dhe Rektori. Ortaku me kuotën më të lartë në shoqëri drejton Bodin Drejtues dhe ka titullin President i TBU. Presidenti i TBU bashkëfirmos diplomatet e studimeve.

Sa herë e konsiderojnë të arësyeshme, ortakët e tjerë të shoqërisë mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues.

Në mbledhjen e Bordit Drejtues, sipas çështjeve dhe interesit, mund të ftohen anëtarë të tjerë nga strukturat akademike të TBU, personalitete shqiptare dhe/ose të huaj si dhe studentë.

Në ndihmë të Bordit Drejtues ngrihet dhe vepron edhe Bordi Këshillimor Ndërkombëtar, i cili përbëhet nga personalitete të njohura të botës akademike, biznesit dhe qeverisjes, brenda dhe jashtë vendit, të përzgjedhur nga Bordi Drejtues.

Mbledhjet e Bordit Drejtues thirren kur këtë e kërkon Presidenti, Administratori ose Rektori dhe drejtohen nga Presidenti i TBU e në mungesë të tij nga Administratori.

Neni 11

Senati Akademik

Senati Akademik (Senati) është autoritet rregullator akademik i TBU i përbërë nga: Rektori, Zëvendës Rektori, Dekanët, Përgjegjësat e Departamenteve dhe Qendrave të Kërkimit, katër vetë nga personeli akademik me tituj dhe gradat më të larta që identifikohen nga Rektori si dhe dy studentë, një për çdo fakultet që identifikohen dhe propozohen nga Dekanët duke i përzgjedhur mes studentëve me rezultatet më të larta në fakultetin respektiv dhe miratohen nga Rektori.

Administratori dhe/ose Presidenti i TBU mund të marrin pjesë në mbledhjet e Senatit, sa herë e konsiderojnë të arësyeshme, mund të diskutojnë për çështjet e rendit të ditës, por pa të drejtë vote.

Mbledhja e Senatit thirret nga Rektori i cili është edhe drejtuesi i Senatit.

Senati ka keto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. Garanton respektimin e parimeve të autonomisë dhe mundësive të barabarta të lirisë akademike e të kërkimit, si dhe të drejtat e studentëve;
2. Miraton projekt planin disaveçar të zhvillimit strategjik të institucionit për sa i përket anës mësimore, kërkimore shkencore, etj;
3. Miraton projekt buxhetin vjetor
4. Miraton projekt statutin e TBU dhe/ose projekt ndryshimet e tij
5. Miraton projekt programet e reja të studimit, të kërkimit e zhvillimit apo pjesë të tyre si dhe projektet për hapjen, ndryshimin ose mbylljen e njësive mësimore ose kërkimore.
6. Miraton programin vjetor të veprimtarive mësimore, kërkimore, shkencore të TBU-së;
7. Miraton Rregulloren e Përgjithshme të TBU
8. Zgjedh anëtarët e Këshillit të Etikës dhe miraton Rregulloren e Etikës
9. Zgjedh anëtarët e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe miraton rregulloren e funksionimit të saj
10. Miraton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore.
11. Çdo përgjegjësi ose kompetencë tjetër e parashikuar në këtë statut dhe në akte të tjera rregullatore
12. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet ekskluzivisht Senatit nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë.

Mbledhjet e Senatit janë të vlefshme kur merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast barazie të votave pro dhe kundër vota e Rektorit është përcaktuese.

Neni 12

Rektori

Rektori është autoriteti drejtues kryesor i veprimtarisë akademike të TBU-së. Ai garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Rektori duhet të zotërojë titullin "Profesor", "Profesor i asociuar" ose gradën shkencore "Doktor". Ai emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Marrëdhëniet e tij të punës me shoqërinë përcaktohen në kontratën e tij të punës.

Rektori ka këto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. Përfaqëson TBU në marrëdhënie me autoritetet shtetërore arsimore dhe institucionet arsimore për çështje që lidhen me veprimtarinë akademike të TBU. .
2. Mund të përfaqësojë TBU-në në aktivitete të ndryshme, shkencore, publike, mediatike, etj, që ai i gjykon në interes të TBU-së, si edhe në veprimtaritë promovuese të shkollës.
3. I propozon Asamblese së Përgjithshme të Shoqërisë kandidatura për Dekan dhe/ose shkarkimin e tij.
4. Emëron dhe shkarkon përgjegjësit e departamenteve dhe qendrave si dhe personelin akademik të propozuar nga Dekani.
5. Harton projektet e të gjitha akteve dhe dokumenteve që miratohen nga Senati;
6. Miraton rregulloret e programeve mësimore të propozuar nga Dekani.
7. Shfuqizon aktet e autoriteteve akademike poshtë tij në hierarkinë institucionale kur ato nuk respektojnë politikat e miratuara nga: Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, Bordi Drejtues, Senati, Rektori; ose kur këto akte bien ndesh me interesat e TBU.
8. Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, Bordi Drejtues;
9. Miraton planet mësimore të programeve të studimit
10. Miraton strukturën akademike të vitit mësimor.
11. Rektori raporton një herë në vit në Bordin Drejtues lidhur me ecurinë dhe realizimin e objektivave të vendosura për aktivitetin akademik;
12. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të brendshëm e të jashtëm të veprimtarisë së institucionit;
13. Rektori nënshkruan diplomat e studimeve.
14. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë tjetër e parashikuar në këtë statut ose në akte të tjera rregullatore
15. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet ekskluzivisht Rektorit nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë.

Neni 13

Këshilli i Etikës

Këshilli i Etikës ngrihet dhe funksionon mbi bazën e Statutit të shkollës si dhe të Rregullores së Etikës të miratuar nga Senati Akademik.

Rregullorja e Etikës përcakton mënyrën e marrjes së vendimeve, paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, ekzekutimin e vendimeve dhe sanksionet përkatëse.

Anëtarët e Këshillit të Etikës zgjidhen drejtpërdrejt nga Senati Akademik. Në përbërje të tij janë tre ose pesë persona.

Neni 14

Autoritete drejtuese të fakultetit

Autoritete drejtuese në Fakultet janë: Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës

Neni 15

Dekani

Dekani është autoriteti drejtues kryesor i veprimtarisë akademike të Fakultetit. Ai garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në atë fakultet. Dekani duhet të zotërojë titullin "Profesor", "Profesor i asociuar" ose gradën shkencore "Doktor". Ai emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve bazuar edhe në kandidaturat e sugjeruara nga Rektori. Marrëdhëniet e tij të punës me shoqërinë përcaktohen në kontratën e tij të punës.

Dekani ka këto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. Mund të përfaqësojë Fakultetin ose TBU-në në aktivitete të ndryshme, shkencore, publike, mediatike, etj, që ai i gjykon në interes të TBU-së, si edhe në veprimtaritë promovuese të shkollës
2. I propozon Rektorit emërimin dhe shkarkimin e Përgjegjësit të Departamentit/Qendres si dhe të personelit akademik të Fakultetit.
3. Harton të gjitha projekt-aktet që miratohen nga Senati përmes propozimit të Rektorit për atë pjesë dhe çështje që i takojnë Fakultetit.
4. Harton projekt-rregulloret e programeve mësimore të Fakultetit
5. Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Rektori, Senati dhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
6. Dekani raporton një herë në përfundim të çdo semestri në Senat lidhur me ecurinë dhe realizimin e objektivave të vendosura për aktivitetin mësimor, kërkimor dhe shkencor në Fakultetin që ai drejton;
7. Dekani nënshkruan diplomën/certifikatën e studimeve të Fakultetit.
8. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë tjetër e parashikuar në këtë Statut dhe në akte të tjera rregullatore
9. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet ekskluzivisht Dekanit nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë

Neni 16

Departamenti

Departamenti është njësi bazë mësimore dhe kërkimore që grupon disiplinat mësimore me natyrë të përafert. Në Departament përfshihet i gjithë personeli akademik përkatës pavarësisht se ndokush mund të kryejë edhe funksione të tjera në shkollë.

Neni 17

Përgjegjësi i Departamentit

Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit e cili duhet të ketë të paktën gradën Doktor. Ai propozohet nga Dekani dhe miratohet nga Rektori.

Përgjegjësi ka këto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. Në bashkëpunim me stafin akademik të departamentit kontribuon në hartimin e të gjitha projekt-akteve që miratohen dhe/ose percillen nga Dekani, Rektori, Senati.
2. I sugjeron Dekanit kandidatët për personel akademik
3. Bën periodikisht analizën e punës mësimore dhe kërkimore të Departamentit dhe propozon e merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj.
4. Përfaqëson Departamentin dhe vepron në emër të tij në marrëdhënie me autoritete e tjera të shkollës.
5. Bën të njohur arritjet e Departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte dhe, në bashkëpunim me strukturat e tjera të shkollës, përditësimin të rubrikave përkatëse në faqen eeb të TBU etj.
6. Ndjek dhe përgjigjet për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të Departamentit.
7. Organizon dhe drejton punën për hartimin e teksteve mësimore për lëndët që mbulon Departamenti.
8. Bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe asaj kërkimoreme stafit akademik të Departamentit.
9. Miraton komisionet e provimeve.
10. Propozon përbërjen e komisioneve për provimet e formimit dhe mbrojtjen e temave të diplomave.
11. Cdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë tjetër e parashikuar në këtë statut dhe në akte të tjera rregullatore
12. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet ekskluzivisht Përgjegjësit të Departamentit nga legjisllacioni në fuqi për arsimin e lartë

Neni 18

Qendra kërkimore

Qendra për kërkime dhe studime ekonomike si dhe ajo juridike janë njësi bazë, që funksionojnë pranë fakultetit respektiv : Fakultetit të Administrim Biznesit dhe Fakultetit E Drejta e Biznesit.

Qendra organizon dhe drejton veprimtarinë kërkimore të Fakultetit

Qendra drejtohet nga Përgjegjësi i saj, i cili/e cila ka të paktën gradën "Doktor" ..

Përgjegjësi i Qendrës ka këto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. bashkërendon planin e punës kërkimore me departamentet e fakulteteve;
2. organizon veprimtari shkencore dhe/ose në bashkëpunim me universitete të tjera vendase ose të huaja;
3. zhvillon konferenca, simpoziume, forume shkencore, tryeza diskutimesh universitare, ndëruniversitare dhe ndërkombëtare;
4. tërheq dhe aktivizon në veprimtarinë shkencore dhe botuese studentët më të mirë të fakulteteve, përgatit për studentët module suplementare dhe veprimtari të tjera të ngjashme;
5. boton dhe publikon, përveç teksteve mësimore, edhe përmbledhje studimesh, referatesh, kumtesash, etj.

6. çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë tjetër e parashikuar në këtë statut dhe në akte të tjera rregullatore
7. çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet ekskluzivisht Përgjegjësit të Qendres nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë

Neni 19

Qeveria Studentore (Këshilli i Studentëve)

Qeveria Studentore (ose Këshilli i Studentëve) është organizim i pavarur i studentëve të TBU, e cila nuk lejohet të zhvillojë veprimtari politike dhe ekonomike brenda shkollës. Ajo promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të TBU-së, në strukturat mësimore kërkimore dhe në shërbimet pranë tij.

Qeveria Studentore zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve dhe mund të organizohet në nivel fakulteti dhe/ose institucioni.

Qeveria Studentore shpreh hapur mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm që lidhen me veprimtarinë mësimore kërkimore të TBU-së, siç janë: planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtarinë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, për zhvillime të veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike e sportive.

Autoritete e shkollës inkurajojnë dhe mbështesin Qeverinë Studentore në aktivitetin e saj por pa ndërhyrë në punët e saj të brendshme.

KREU III

NJËSITË ADMINISTRATIVE

Neni 20

Sekretaria mësimore

Në TBU vepron sekretaria mësimore si struktura administrative themelore në shërbim të procesit mësimor. Ajo përgjigjet për gjithë organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të regjistrimeve, të transferimeve, të provimeve, për procesin e lëshimit të diplomave, mbajtjen e regjistrit të të dhënave të studentëve, etj.

Sekretaria mësimore organizon punën e saj mbështetur në një rregullore të brendshme, e cila propozohet nga Rektori dhe miratohet nga Senati Akademik.

Sekretarja mësimore ka këto përgjegjësi dhe/ose kompetenca:

1. është përgjegjës për regjistrimin dhe matrikullimin e studentëve dhe krijimin, sistemimin dhe mbajtjen sekret të të dhënave të tyre;
2. është përgjegjës për zbatimin e procedurave të transferimit të studentëve dhe përgjigjet për plotësimin e dokumentacionit përkatës;
3. shpall orarin e miratuar të mësimave, praktikave, konsultimeve, provimeve dhe ndjek e kontrollon zbatimin e tij;
4. është përgjegjës për përgatitjen dhe lëshimin e fletëve të provimit;
5. është përgjegjës për shpalljen e përfundimeve të kontrollit të dijeve duke respektuar të drejtën e studentit mbi privatësinë e të dhënave të veta;
6. është përgjegjës për dokumentimin e lidhjeve të ndërsjella në fushën e shkëmbimit e transferimit të

- studentëve me institucione homologe;
7. ndjek realizimin nga secili student të planit individual të studimit dhe njofton studentin kur vë re se ka shmangie nga plani individual i studimit;
 8. ndjek punën për informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me ecurinë e rezultateve të tyre dhe njofton me shkrim Rektoratit kur ecuria e rezultateve nuk kënaq kërkesat e studimeve;
 9. është përgjegjës për komunikimin periodik me familjarët dhe informimin e tyre për ecurinë e studentit;
 10. i propozon Rektoratit veprime që i shërbejnë rritjes së cilësisë në dokumentimin e të dhënave dhe në shërbimet ndaj komunitetit të studentëve;
 11. ndjek mbarëvajtjen e veprimtarisë mësimore të TBU-së dhe informon Dekanët përkatës dhe departamentet, kur ndesh ose vihet në dijeni për shmangie nga zbatimi i programeve mësimore të miratuara, për mosrespektim të orarit të mësimave, për zbatim jokorrekt të procedurave të kontrollit të dijeve, etj;
 12. përgatit për vendimmarrje dokumentacione të aplikimit, të regjistrimit, të ndërprerjes apo rifillimit të studimeve dhe të transferimit;
 13. është përgjegjës për plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor dhe pranimin dhe lëshimin e vërtetimeve, certifikatave dhe dokumenteve të tjera;
 14. nxjerr dhe përgatit në kohë të dhëna të ndryshme mbi mbarëvajtjen dhe rezultatet e studentëve, numrin e tyre sipas viteve e degëve si dhe për realizimin e ngarkesave mësimore nga ana e personelit akademik, me kërkesën e drejtuesve akademikë e administrativë të institucionit.

Neni 21

Zyra e çështjeve studentore

Zyra e çështjeve studentore merren me çështjet studentore dhe problemet e veçanta të studentëve. Ajo përbëhet nga dy persona.

Çështje të kësaj Zyre janë:

1. Rekrutimi dhe pranimi, që nënkupton marrëdhëniet me sistemin parauniversitar, me bashkëpunëtorët e universitetit, koordinon prezantimin e ofertës së TBU në shkollat e mesme, pranimet e studentëve të rinj, etj.
2. Orientimi, alumini dhe karriera, që nënkupton orientimin e studentëve të TBU për formimin dhe karrierën e tyre, udhëheq organizimin, aktivitetet e shërbimet ndaj studentëve të diplomuar (alumni), koordinon marrëdhëniet me komunitetin, me shoqatat e prindërve, etj.
3. Shërbimet akademike, që nënkupton veprimtari që lidhen me kartën e studentit, javën e akomodimit, shërbimet e IT për studentët, lidhjet ndërkombëtare të studentëve (në bashkëpunim me sektorin e marrëdhënieve ndërkombëtare), tutoratin akademik, aktivitetet ndihmëse të formimit, si: lektoriume, auditoriume, praktikume, harton kalendarin vjetor të aktiviteteve kulturore e sportive dhe drejton realizimin e tyre, etj.

Neni 22

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë siguron drejtimin, këshillimin dhe mbështetjen për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë për të siguruar zbatimin e standardeve të larta në përputhje me

legjislaconin shqiptar dhe atë evropian në fushën e arsimit të lartë dhe veçanërisht me ato të lidhura me sigurimin e cilësisë akademike, si dhe me aktet e brendshme të institucionit.

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë harton një raport vjetor, në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime në lidhje me respektimin e standardeve shtetërore të cilësisë, në kuadrin institucional dhe atë të programeve të studimit që institucioni ofron.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj Njësie rregullohet me një rregullore të posaçme, që miratohet nga Senati Akademik.

KREU IV

PERSONELI I UNIVERSITETIT

Neni 23

Personeli i TBU përbëhet nga:

- a. personeli akademik;
- b. personeli ndihmës mësimor – kërkimor;
- c. personeli administrativ.

Neni 24

Personeli akademik

Personeli akademik i TBU përbëhet nga profesorë, profesorë të asociuar, doktorë, lektorë dhe seminariste, të cilët kryejnë veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore.

Personeli akademik kryen edhe veprimtari të tjera në ndihmë të institucionit si dhe konsultime e këshillim për studentët.

Në TBU preferohet personel akademik që njëkohësisht ushtron veprimtari private ose është i vetëpunësuar ose i punësuar në sektorin privat apo shtetëror në sektorë apo detyra që lidhen me lëndën në të cilën ai jep mësim.

Neni 25

Personeli ndihmës mësimor kërkimor

Personeli ndihmës mësimor përbëhet nga asistentë të personelit akademik, nga personeli ndihmës i qendrës së kërkimit dhe personeli ndihmës i departamenteve, të cilët mund të kryejnë veprimtari të mësimdhënies dhe kërkimit nën drejtimin e personelit akademik dhe/ose të qendrës; ata kryejnë njëkohësisht edhe veprimtari të tjera në ndihmë të institucionit si dhe konsultim dhe këshillim për studentët.

Mënyra e konkurrimit dhe përzgjedhjes së personelit ndihmës mësimor kërkimor rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 26

Personeli administrativ

Personeli administrativ i TBU përbëhet nga drejtuesit administrativ, punonjësit administrativë, personeli i shërbimit dhe punonjësit e tjerë. Mënyra e konkurrimit, përzgjedhjes dhe emërimit të personelit administrativ rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

Ngarkesa mësimore , kërkimore dhe e detyrave të tjera të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ.

Ngarkesa përcaktohen me udhëzime të veçanta të miratuara nga asambleja e ortakëve që pasqyrohen në aktet rregullatore dhe/ose në kontratat e punës të lidhura mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Neni 28

Koha e punës dhe e pushimit

Në TBU, koha normale javore e punës është 40 orë; koha ditore normale e punës nuk është me e madhe se 8 orë. Koha konkrete dhe organizimi i punës përcaktohen në aktet rregullatore dhe/ose në kontratën e punës. Pushimi vjetor caktohet në përputhje me Kodin e Punës. Çështjet e tjera lidhur me kohën e punës e të pushimit, zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi mbi marrdhënit e punës dhe kontratës së nënshkruar mes punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Neni 29

Kualifikimi

Personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-kërkimor dhe personelit administrativ u njihet e drejta e kualifikimit të vazhduar në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara në fakultete, në interes të zhvillimeve shkencore e akademike të fakulteteve dhe institucionit, si edhe sipas kërkesave ligjore në fuqi.

KREU V

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 30

Forma e studimeve

Format e studimit në TBU do të jenë:

- a) Studime me kohë të plotë.
- b) Studime me kohë të zgjatur
- c) Studime në distancë.

Neni 31

Ciklet dhe titujt e studimeve

Programet e studimeve në SHLP TBU organizohen në dy cikle:

1. Studimet e ciklit të parë synojnë:
 - a) të japin njohuritë bazë mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në profilet e zgjedhura;
 - b) realizohen me të paktën 180 kredite;
 - c) në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diplomë Bachelor sipas specialitetit të kryer.
2. Studime të ciklit të dytë:

- a) japin njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim të pavarur në një fushë brenda një specialiteti;
- b) ato realizohen me të paktën 60, 90 dhe 120 kredite
- c) në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të dytë lëshohet diplomë Master Profesional me 60 ECTS, Master Profesional me 90 ECTS dhe Master i Shkencave me 120 ECTS në specialitetin e kryer.

Programet e studimit që ofrohen në ciklin e parë të studimeve nga SHLP TBU janë si më poshtë:

1. **Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Menaxhim.** 180 ECTS, forma e studimit: me kohë të plotë - kohëzgjatja 3 vite akademike, dhe me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 4 vite akademike.
2. **Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Marketing.** 180 ECTS, forma e studimit: me kohë të plotë - kohëzgjatja 3 vite akademike, dhe me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 4 vite akademike.
3. **Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Financë-Kontabilitet.** 180 ECTS, forma e studimit: me kohë të plotë - kohëzgjatja 3 vite akademike, dhe me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 4 vite akademike.
4. **Bachelor në E Drejtë Biznesi,** 180 ECTS, forma e studimit: me kohë të plotë - kohëzgjatja 3 vite akademike, dhe me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 4 vite akademike.

Emërtimi i diplomave që do të lëshohen nga SHLP TBU:

- Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Menaxhim.
- Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Marketing.
- Diplomë Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Financë-Kontabilitet.
- Diplomë Bachelor në E Drejtë Biznesi.

Programet e studimit që ofrohen në ciklin e dytë të studimeve nga SHLP TBU janë si më poshtë:

I. MASTER PROFESIONAL

1. **Master Profesional në Administrim Biznesi.** 90 ECTS, forma e studimit: me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 2 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 1,5 vite akademike.
2. **Master Profesional në Administrim Biznesi, Profili Finance - Kontabilitet -.** 90 ECTS, forma e studimit: me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 2 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 1,5 vite akademike.
3. **Master Profesional në Administrim Biznesi, Profili E Drejtë Biznesi.** 90 ECTS, forma e studimit: me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 2 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 1,5 vite akademike.
4. **Master profesional në Administrim Publik.** 60 ECTS, forma e studimit: me kohë të pjesshme - kohëzgjatja 1,5 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 1 vit akademik.
5. **Master profesional në E Drejtë Biznesi.** 60 ECTS, forma e studimit: me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 1,5 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 1 vit akademik.

II. MASTER I SHKENCAVE

1. **Master i Shkencave në Administrim Biznesi.** 120 ECTS, forma e studimit: me kohë të zgjatur - kohëzgjatja 3 vite akademike, dhe me kohë të plotë - kohëzgjatja 2 vite akademike.

Emërtimi i diplomave që do të lëshohen nga SHLP TBU është:

- Diplomë Master Profesional në Administrim Biznesi.
- Diplomë Master Profesional në Administrim Biznesi, Profili Financë - Kontabilitet -.
- Diplomë Master Profesional në Administrim Biznesi, Profili E Drejtë Biznesi.
- Diplomë Master Profesional në Administrim Publik.
- Diplomë Master Profesional në E Drejtë Biznesi.
- Diplomë Master i Shkencave në Administrim Biznesi.

SHLP TBU mund të hapë programe të reja të studimeve në përputhje me të gjitha kërkesat dhe procedurat ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi.

Neni 32

Elementë të programeve të studimit

Programet e studimeve të ciklit të parë dhe ciklit të dytë si dhe ato specializuese ose të formimit të vazhduar përmbajnë elementët e mëposhtëm:

- a. të dhëna të përgjithshme të programit, formën dhe objektivat kryesore, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve;
- b. klasifikimin e programit të studimit që bëhet i zbatueshëm me krijimin e kuadrit shtetëror të kualifikimeve;
- c. kushtet e pranimeve në programin e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes në rastin e pranimeve me numër të kufizuar;
- d. metodat e vlerësimit të studentëve dhe kushtet për përparim në program;
- e. kushtet për transferimet ndërmjet programit dhe kushtet për përfundimin e pjeshëm të programit kur parashikohet.
- f. titujt akademikë dhe profesionalë, që akordohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 33

Programet e studimeve ndërdisiplinore

TBU mund të organizojnë programe të përbashkëta të studimeve ndërdisiplinore bachelor dhe master. Programe të tilla organizohen në bashkëpunim midis të dy fakulteteve të administrim biznesit dhe të drejtës së biznesit.

Në përfundim të programeve të studimeve ndërdisiplinore lëshohet diplomë e përbashkët nga të dy Fakultetet.

Neni 34

Programet e studimeve të formimit të vazhduar

TBU do të ofrojë programe të studimit të formimit të vazhduar si formë e studimit gjatë gjithë jetës për specializime afatshkurtra, plotësime, thellime dhe freskime të njohurive dhe/ose programe të edukimit të avancuar. Këto programe i ndihmojnë individët në rritjen e kualifikimit të tyre dhe rritjen e aftësive profesionale.

TBU mund të organizojë kurse, shkolla verore dhe veprimtari të ngjashme me to.

Në përfundim të programeve të studimeve të formimit të vazhduar, lëshohet si rregull certifikate, dhe kur bën, diplomë.

Neni 35

Programet e studimeve të përbashkëta

TBU mund të ofrojë programe të studimeve të llojeve të mësipërme të përbashkëta që mund të realizohen në bashkëpunim me një ose disa institucione të tjera të arsimit të lartë, publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë/certifikate e përbashkët ose diplomë/certifikate e dyfishtë.

Neni 36

Diploma dhe Suplementi. Certifikata

TBU i pajis studentët që kanë përfunduar një program studimi me diplomën/certifikatën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.

Diplomat për ciklin e parë dhe për ciklin e dytë shoqërohet me suplementin e diplomës, përmbajtja dhe forma e të cilave përcaktohet nga Senati në përputhje me udhëzimet e MASH.

Në rastet kur bën kuptim, edhe çertifikata mund të shoqërohet me suplementin e saj.

Diploma ose çertifikata e lëshuar, për rastet e parashikuara nga ligji, regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave ose çertifikatave për arsimin e lartë ose formimin profesional që mbahen nga autoritetet kompetente sipas legjisllacionit në fuqi.

KREU VI

MARRËDHENIET ME SHKOLLA DHE ORGANIZATA BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Neni 37

Marrdheniet me shkolla dhe organizata brenda dhe jashte vendit

TBU ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me universitete dhe institucione të tjera mësimore, kërkimore dhe shkencore, brenda dhe jashtë vendit me qëllim të organizimit të programeve të përbashkëta të studimit, organizimin e kurseve të trajnimit dhe kualifikimit afatshkurtër, organizimin e forumeve, simpoziumeve dhe konferencave shkencore, realizimin e kërkimeve, studimeve dhe publikimeve të përbashkëta, lëshimin e diplomave të përbashkëta, shkëmbimin e përvojave akademike, shkencore, etj.

TBU ka të drejtën e ndërtimit të marrëdhënieve me kompani dhe organizata biznesi, institucione publike dhe jo publike, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim realizimin e praktikave mësimore të studentëve, realizimin e projekteve të përbashkëta me interes të ndërsjellë, si edhe aktivitete të ndryshme në shërbim të realizimit të misionit dhe objektivave të TBU-së.

KREU VII

FINANCIMI I VEPRIMTARISË. BUXHETI

Neni 38

Financimi i veprimtarisë ekonomike

TBU, është institucion arsimor privat që financohet nga burimet e veta që vijnë nga kuotat e pranimit të studentëve dhe të ardhurat e tjera që krijohen nga shërbime që kryhen në përputhje me objektin e veprimtarisë të TBU-së, si edhe nga kontributet e ortakëve të shoqërisë dhe donacionet të tjera që sigurohen nga burime të ligjshme.

Neni 39

Buxheti dhe administrimi financiar

Bordi Drejtues sipas konsultimeve të kryera në Senatën Akademik, miraton buxhetin vjetor për të gjitha investimet dhe shpenzimet e nevojshme, për funksionimin e të gjithë veprimtarisë mësimore, kërkimore, administrative dhe promovuese. Kur kërkohet miratim për subvencione nga TBU sh.p.k. Bordi Drejtues ia kalon çështjen për kompetencë Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Asambleja ka kompetencë ekskluzive për tarifën e studimit, llojet e bursave studentore dhe kriteret e përfitimit të tyre, pagat e personelit dhe çdo çështje tjetër financiare.

Fondet për kërkimin dhe studimet e ndryshme shkencore, për pajisjen e laboratorëve, për organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme shkencore, kur është e mundur, përcaktohen si zë më vete në buxhetin e shkollës.

Gjithçka tjetër lidhur me veçoritë e zbatimit të rregullave të kontabilitetit e të administrimit të vlerave materiale e monetare të TBU-sh.p.k. së, i nënshtrohet akteve ligjore e nënligjore që janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

KREU VIII

VULA ZYRTARE DHE STEMA

Neni 40

Vula dhe stema

Shkolla e Lartë Private "Tirana Business University" ka vulën e saj zyrtare, si edhe logon e saj që vendoset në të gjithë korrespondencën e saj zyrtare.

KREU IX

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 41

Aktet e tjera rregullatore në zbatim dhe zbatim të Statutit të Shkollës

Në përputhje me Ligjin Nr. 9741 datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", me statutin e shoqërisë si dhe me këtë Statut të TBU përshtaten, hartohen dhe miratohen aktet e tjera rregullatore të shkollës.

Presidenti dhe Kryetar i Bordit Drejtues të TBU

Artan Hoxha